**R E P U B L I K A E SH Q I P Ë R I S Ë**
**BASHKIA MALËSI E MADHE**
**KËSHILLI**

Nr. 2331/2 Prot. Datë 04 / 09 2025

V E N D I M

**NR 24 DATË 03 / 09 / 2025**

PËR MIRATIMIN E PLANEVE TË MBARËSHTIMIT TË EKONOMIVE PYJORE

"BZHETË - DEDAJ", "BAJZË - HOT"
"KASTRAT - ZAGORË", "KOPLIK - GRUEMIRË", "FUSHË E ZEZË", "LUGINA E RRJOLLIT", "BOGË"

Këshilli i Bashkisë Malesi e Madhe në mbledhjen e datës 03.09.2025, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Administrimi te Pyjeve si dhe në mbështetje të nenit 3, nenit 8, nenit 9, pika l, nënpika I . l, shkronja ' 'a", nenit 27 pika 5, nenit 55 pika 6, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, ligjit nr. 115 datë 31.07.2014 "Për ndarjen Administrativo-Territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 11, pika 2, shkronja ' 'b" të ligit nr. 57, datë 30.04.2020 "Për pyjet", nenit 14 të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor", të ndryshuar, Vendimit nr. 433, datë 08.06.2016 të Këshlllit të Ministrave "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish- komunave/bashkive", të ndryshuar:

V E N D O S I

1. Të miratojë në parim planet e mbarështimit të ekonomive pyjore "Bzhetë - Dedaj", "Bajzë Hot" "Kastrat - Zagorë", "Koplik - Gruemirë", "Fushë E Zezë", "Lugina E Rrjollit", "Bogë"sipas dokumentacionit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij projektvendimi.
2. Për zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Administrimit te Pyjeve për ndjekjen e procedurave të mëtejshme për miratimin e planeve të mbarështimit, pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr. 139/2015 "Për Veteqeverisjen Vendore",

KRYETAR
Ilir Halaj

SEKRETAR
Emirjan Hasmujaj
Miratuar me 03.09.2025
Vota Pro 16
Vota Kunder 6
Vota Abstenim 6
Zbardhur me datë 04.09.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALËSI E MADHE


*Koplik-Qëndër tel:021122650/2651 e-mail:bashkiamalësiemadhe@hotmail.com*

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA MALËSI E MADHE**
**DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PYJEVE**

Nr.2331/1 Prot. Datë 27/08 2025

PROJEKT VENDIM

Nr. _______, datë __________2025

PËR MIRATIMIN E PLANEVE TE MBARËSHTIMIT TE EKONOMIVE PYJORE

"BZHETË - DEDAJ", "BAJZË - HOT"
"KASTRAT - ZAGORË", "KOPLIK - GRUEMIRË", "FUSHË E ZEZË", "LUGINA E RRJOLLIT", "BOGË"

Këshilli i Bashkisë Malesi e Madhe, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Administrimi te Pyjeve si dhe në mbështetje të nenit 3, nenit 8, nenit 9, pika l, nënpika I . l, shkronja ' 'a", nenit 27 pika 5, nenit 55 pika 6, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, ligjit nr. 115 datë 31.07.2014 "Për ndarjen Administrativo-Territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 11, pika 2, shkronja ' 'b" të ligit nr. 57, datë 30.04.2020 "Për pyjet", nenit 14 të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor", të ndryshuar, Vendimit nr. 433, datë 08.06.2016 të Keshlllit të Ministrave "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish- komunave/bashkive", të ndryshuar:

VENDOSI

1. Të miratojë në parim planet e mbarështimit të ekonomive pyjore "Bzhetë - Dedaj", "Bajzë Hot" "Kastrat - Zagorë", "Koplik - Gruemirë", "Fushë E Zezë", "Lugina E Rrjollit", "Bogë"sipas dokumentacionit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij projektvendimi.
2. Për zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Administrimit te Pyjeve për ndjekjen e procedurave të mëtejshme për miratimin e planeve të mbarështimit, pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

**KRYETAR**

**TONIN MARINAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALËSI E MADHE


*Koplik-Qëndër tel:021122650/2651 e-mail:bashkiamalësiemadhe@hotmail.com*

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA MALËSI E MADHE**
**DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PYJEVE**

Nr. 2331 Prot. Date 27/08/ 2025

# RELACION

## PËR MIRATIMIN E PLANEVE TE MBARËSHTIMIT TE EKONOMIVE PYJORE "BZHETË - DEDAJ", "BAJZË - HOT" "KASTRAT - ZAGORË", "KOPLIK - GRUEMIRË", "FUSHË E ZEZË", "LUGINA E RRJOLLIT", "BOGË"

Në mbështetje të nenit 3, nenit 8, nenit 9, nenit 27, nenit 55, të ligjit nr. 139/201 5 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, ligjit nr. 1 15 datë 31 .07.2014 "Për ndarjen Administrativo-Territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nenit I I , pika 2, shkronja "b" të ligjit nr. 57, datë 30.04.2020 "Për pyjet", nenit 14 të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor", të ndryshuar, Vendimit nr. 433, datë 08.06.2016 të Këshillit të Ministrave "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish- komunave/bashkive", të ndryshuar, gjatë marrjes ne dorëzim dhe vlerësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të fondit pyjor dhe kullosor që ka kaluar në pronësi të Bashkisë Malësi e Madhe është konstatuar se planet e mbarështimit rezultonin të ishin hartuar kryesisht në vitet 1983-1985. Në kuptim të zbatimit në praktikë të planeve të vjetra të mbarështimit është vërejtur se nuk pasqyrojnë ndryshimet që kanë ndodhur në fondin pyjor dhe kullosor si në volum, sipërfaqe, Lloj pyjor, etj., në vitet e fundit. Këto plane aktualisht janë të pavlefshme në referencë të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020 "Për pyjet", e cila ka përcaktuar si afatin maksimal të vlefshmërisë së planeve të mbarështimit ka afatin 10 vjeçar.

Planet e vjetra të mbarështimit nuk garantojnë një zhvillim dhe menaxhim të qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullosor.

Menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore të pyjeve, kullotave dhe livadheve nënkupton mirëqeverisjen dhe përdorimin e resurseve në një mënyrë dhe me një ritëm që ruan dhe siguron biodiversitetin, prodhimtarinë, aftësinë ripërtëritëse, vitalitetin dhe potencialin e tyre për të përmbushur, për sot dhe të ardhmen, funksionet ekologjike, ekonomike dhe sociale në nivel lokal, kombëtar dhe global.

Në këto kushte gjatë një propozimi për financim nga Banka Botërore, e kontraktuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit e cila ka kontraktuar kompanitë Abkons dhe Oikon Croatia të cilat janë shpallur fituese për përgatitjen e planeve të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave të Bashkisë Malësi e Madhe, të cilat janë selektuar nga Sektori i Pyjeve, aktualisht Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave janë përgatitur shtatë plane mbarështrimi të Ekonomive Pyjore "Bzhetë - Dedaj", "Bajzë - Hot" "Kastrat - Zagorë", "Koplik - Gruemirë", "Fushë E Zezë", "Lugina E Rrjollit", "Bogë"

Detyrat që janë ndjekur nga subjekti i kontraktuar me qëllim hartimin e planit të mbarështimit të pyjeve janë: Grumbullimi dhe shqyrtimi i literaturës për të vlerësuar gjendjen aktuale të burimeve pyjore/kullosore në ekonominë pyjore, përshkrimi i përgithshëm në terren i ngastrave e n/ngastrave, verifikimi i kufijve, përcaktimi definitiv në terren duke shënjuar me bojë vaji kufijtë e tyre, hedhja e ndryshimeve në hartë dhe llogaritja e sipërfaqeve përkatëse, Vlerësimi i

sipërf...es dhe volumit të pyjeve sipas formave të ndryshme të qeverisjes, Trungishte, Cungishte, Shkurre, vlerësimi kullotave/livadhe, përfshirë kapacitetin prodhues të tyre si dhe atë mbajtës, vlerësimin e llojshmërisë dhe sasisë së prodhimeve jo-pyjore (prodhimeve të dyta), identifikimi i problematikës lidhur me aspektet menaxhuese të pyjeve, identifikimi i çështjeve kryesore që kanë të bëjnë me aspektet ligjore, administrative dhe ato të menaxhimit, faktorët dhe aktorët që influencojnë, eksplorimi dhe propozimi i alternativave më të mira të menaxhimit të bazuara dhe të integruara në nevojat e ruajtjes dhe zhvillimit të fondit pyjor dhe të komunitetit të zonës, hartografimi i territorit të zonës (në GIS), duke përfshirë, Ekonominë pyjore, ndarjen e ngastrave e të n/ngastrave, llojet pyjore dhe format e qeverisjes, Përdorimin e territorit të zonës, Masat e propozuara të parashikuara për përmirësimin dhe trajtimin e pyjeve, Ngritjen e një sistemi të përhershëm dhe përkohshëm sipërfaqesh provë për matjen (dhe më tej monitorimin periodik) dhe llogaritjen e volumit të pyjeve, bazuar në udhëzuesin përkatës të hartimit të planit të mbarështimit, Hedhja e të dhënave të grumbulluara në terren dhe përpunimi kompjuterik i tyre. Objektivi i përgjithshëm i planit të mbarështimit është Menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve pyjore/kullosore në pronësi të Bashkisë Malësi e Madhe (edhe nga këndvështrimi ekologjik), me strukturë dhe cilësi të mirë në përshtatje me kushtet e zonës dhe në përputhje me objektivat e mbarështimit. Objektivat specifikë të planit të mbarështimit janë: Përcaktimi i përdorimit të territorit në përputhje me gjendjen lokale dhe nevojat, Përmirësimi dhe mirëmbajtja në një gjendje të mirë funksionale të grumbujve pyjor, Rritja e prodhimtarisë së pyjeve Me funksion prodhues, Përmirësimi i cilësisë dhe gjendjes së grumbujve të tru ngishteve me funksion prodhues, Nxitja dhe përdorimi i ripërtëritjes natyrore sa më shumë që të jetë e mundur me qëllim që të krijohen ekosisteme pyjore që i përshtaten mjedisit, Pakësimi i impakteve negative në gjendjen fitosanitare të pyjeve, dhe prerjeve të paligjshme, Rehabilitimi dhe garantimi i rritjes së qëndrueshme të prodhimtarisë në sipërfaqet pyjore/kullosore.

Në këto kushte dhe bazuar në nenin 54 të ligi it nr. 1 39/2015 ”Për vetëqeverisjen vendore”, nenit I l , pika 2, shkronja "b” të ligjit nr. 57, datë 30.04.2020 ”Për Pyjet”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 433, datë 08.06.2016, për "Transferimin në pronësi të bashkive, të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave te inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/ Bashkive", në ”Manualin e Planeve të Mbarshtrimit të Pyjeve dhe Kullotave” miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në Janar 2019, i propozojmë

Këshillit të Bashkisë Malësi e Madhe të miratojë planet e mbarështimit për ekonomitë pyjore "Bzhetë - Dedaj", "Bajzë - Hot" "Kastrat - Zagorë", "Koplik - Gruemirë", "Fushë E Zezë", “Lugina E Rrjollit”, “Bogë”

Bashkëngjitur gjeni dhe një përmbledhje te planeve te mbarështimit te këtyre ekonomive pyjore dhe kullosore.

KRYETAR

TONIN MARINAJ

PËRMBAJTIA E RAPORTIT FINAL MBI PLANET E MBARËSHTRIMIT TË EKONOMIVE PYJORE "BZHETË - DEDAJ", "BAJZË - HOT" "KASTRAT - ZAGORË", "KOPLIK - GRUEMIRË", "FUSHË E ZEZË", “LUGINA E RRJOLLIT”, “BOGË”

## 1. EKONOMIA PYJORE " BZHETË - DEDAJ ".

**Informacion i përgjithshëm rreth Ekonomisë Pyjore.**

Ekonomia pyjore “Bzhet-Dedaj”, është inventarizuar për herë të fundit në vitin 1984-1985, pra para 36 viteve dhe është hartuar bazuar ne manualin përkatës, nën drejtimin e ish Institutit të Kërkimeve Pyjore dhe Kullotave ne atë periudhe. Ndërsa për here te fundit është mbarshtruar ne vitin 2009 ne kuadrin e pyjeve dhe kullotave ish komunale Shkrel.

Gjatë kësaj periudhe e cila përfshin edhe tranzicionin që po kalon shoqëria jonë, rrjedhimisht edhe pyjet, kjo ekonomi pyjore ka pësuar ndryshime të ndjeshme dhe mjaft të mëdha, si përsa i përket strukturës se pyjeve, ashtu dhe shpërndarjes së vëllimit, sipas klasave të moshës dhe prodhimit, si rrjedhoje e aktivitetit njerëzor mbi këto burime pyjore.

Nisur nga fakti që plani aktual i inventarizimit është shumë i vjetër dhe nuk pasqyron realitetin, ishte e domosdoshme hartimi plani të ri të mbareshtrimit, i cili pasqyron gjendjen reale të grumbujve pyjorë të kësaj ekonomie.

Duhet të nënvizojmë se edhe plani i mbarshtrimit i vitit 2009 i kësaj ekonomije,plan i cili është i integruar së bashku me të gjitha ekonomit pyjore që përfshinte në territorin e saj ishe komuna Shkrel(sot Nj.A.),nuk pasqyron më realitetin prandaj duhet të hartohet plani i menaxhimit që sikurse u nënvizua me larte pasqyron gjendjen reale të grumbujve pyjore në këtë ekonomi.

Në objektivat e këtij plani mbarështrimi është primar: “sigurimi i një mbarështrimi të qëndrueshëm dhe shumë funksional i pyllit”.

*Qëllimi kryesor i hartimit të planit të mbarështrimit është hartimi i një dokumenti që të plotësojë objektivat afat-shkurtra dhe afat mesme në përputhje me gjendjen aktuale dhe atë te pritshme te fondit pyjor, përmbushja e kërkesave dinamike te komunitetit për produktet pyjore dhe jo-pyjore, si dhe për shërbime të tjera në funksion të përmirësimit të jetës të komunitetit*

Janë prezantuar tek të gjithë aktorët objektivat e planit të ri te mbarështimit, duke i vendosur drejtimet kryesore për administrimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave të Ekonomisë Pyjore Bzhet Dedaj.

Bazë për zhvillimin e sektorit pyjore është korniza ligjore ekzistuese, bazuar ne ligjin kuadër 57/2020 “Për pyjet”.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALËSI E MADHE

**Vendodhja gjeografike dhe ndarja administrative.**

Ekonomia Pyjore Bzhet Dedaj si pjese integrale e bashkisë Malësi e Madhe ,bën pjesë në krahinën Malore veri lindore te bashkisë Malësi Madhe. Kjo ekonomi vendoset kryesisht ne Luginë e përroit të thate brenda së cilës përfshihet krahina e Shkrelit.

Ekonomia Pyjore Bzhet Dedaj ka kufij natyrore te dalluar mirë te cilët janë:

1. **Në veri**

veri kufizohet me ekonominë pyjore "Boge", kufiri i secilës fillon ne kotën 840m vazhdon ne majën e Zagore kute 1522m, dhe vazhdon për gjate kurrizit ndarës te parcelave 24.25.26.27, 7a,67a, ngjite përgjatë kurrizit te malit te Rrabes se Ducajve ne kuota 2221m.2190m vazhdon ne koten 2201m ,2263m dhe mbyllet ne kuten2175m

2. **Në lindje**

kufizohet me ekonominë pyjore "Theth(Parku kombëtar)Kufiri i se cilës kalon " 2175m,dhe zbarat nëpërmjet kurrizit ndarës me parkun duke kaluar nëpër kutat1956m,2054m,ne majën e mardonit kuta2179.9m zbret ne 2083m,2065m,klon ne majën e Kamshollit 2016m,2016m dhe mbyllet ne majen2224m.kufizohet me një pjese te kufirit te ekonomisë pyjore qe kalon nëpërmjet kurrizit qe kalon ne kutat;2036m,2026m2080,2075mne majën e Rrasajve te Dedajve,kuota 1903m,Maja e madhe,,

**3.Ne jug**

kufizohet me Qafa e Shtogut në kotën 1862m kalon ne kotat 2030m,1946, dhe vazhdon duke ndjekur kurrizin ndarës me pjesën e ekonomisë pyjore Repisht duke kaluar ne kutat1885m,ne kurrizin e parcelave 131a,132a,133a,153a,154,1604b,zbret ne fshatin dedaj(fushe dedaj,pret kanalin e rrejdhjes se ujit Prrot te thate.

**4.Ne Perëndim**

Kufizohet nga Nga ekonomia pyjore Kastrat Zagor, ku kufiri ndarës i tyre kalon ne kurrizin e parcelës 162,kufiri i parcelës nr. Parcelës 1.2 vazhdon kurrizin deri ne kuotën 1566m duke ecur drejt maje vogël 1762m dhe mbyllet ne kuotën 840m

**Rezultatet kryesore**

Plani i mbarështrimit të Ekonomisë Pyjore "Bzhet Dedaj", me periudhë vlefshmërie 2021 deri 2031, bëhet për herë të Dytë, pas Planit të Inventarizimit të Ekonomisë Pyjore viti 1984-85, si dhe pas hartimit të Planeve të Menaxhimi të pyjeve Komunale (2008-2009), si pjesë e projektit të Menaxhimit pyjeve dhe kullotave komunale e ish komunës Shkrel.

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA MALESI E MADHE

Sipërfaqja totale e Ekonomisë Pyjore Bzhet Dedaj ne vitin 2021 rezulton te jete **7682.23 ha**. Kjo sipërfaqe jepet e detajuar ne tabelën 1 me poshtë:

| Nr. | Përdorimi i territorit | Sip. ha |
|---|---|---|
| 1 | **BULESA PYJORE** | **5613.91** |
| | PYLL | **4420.16** |
| a | Trungishte | 1235.14 |
| b | Trungishte e përberë | 923.07 |
| c | Cungishte | 1588.61 |
| d | Cung. Përbërë | 673.34 |
| e | **Shkurre** | **1119.75** |
| 2 | **Kullota** | 1062.95 |
| a | **Jo pyje** | 31.21 |
| b | **Shkëmbore** | 970.23 |
| 3 | **Tjetër** | |
| | 3.1. In produktivë (eroduar) | |
| | 3.2. Ujore | |
| | 3.3. Bujqësore | |
| | 3.4. Boshe | |
| | 3.5. Urbane | |
| | 3.6 Rruge | |
| | **Totali** | **7682.23** |

Sipas planit të ri të mbarështrimit ndarja e grumbujve pyjorë si mbas formës së qeverisjes është si vijon:

| Nr | Përdorimi i territorit | Viti 1985 | Viti 2021 | Ndryshimi ne +/- |
|---|---|---|---|---|
| 1 | MBULESA PYJORE | 4552.70 | **5613.91** | +1061.2 |
| | PYLL | 3491.15 | **4420.16** | +929.01 |
| a | Trungishte | 3183,15 | 1235.14 | |
| b | Trungishte e përbëre | | 923.07 | -1024.9 |
| c | Cungishte | 308.00 | 1588.61 | |
| d | Cung.perbere | | 673.34 | +1953.9 |
| e | Shkurre | 1061.55 | **1119.75** | +932.2 |
| 2 | **Kullota** | 1228.22 | 1062.95 | -165.2 |
| a | **Jo pyje** | 84.25 | 31.21 | -53.0 |

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA ... E MALESISE

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| b | Shkëmbore | 1116.78 | 970.23 | -.146.5 |
| 3 | Tjetër | | | |
| | Bujqësore | 522.00 | | |
| | **Totali** | **7503.20** | **7682.23** | **+179.0** |

**Pyjet të propozuar me funksion mbrojtës** janë: grumbuj pyjor me qëllim mbrojtjeje dhe që kanë efekt stabilizues në mjedisin natyror.

**Pyjet të propozuar me funksion prodhues** janë grumbuj pyjor që shërbejnë jo vetëm për prodhimin e lëndës drusore por edhe produktet e dyta pyjore.

Ne tabelën nr. 5. Jepet funksioni i propozuar ne kuadër te këtij projektit mbarështimi;

| **Grumbujt e ekonomisë pyjore Bzhet dedaj sipas funksionit (P.M 2021)** | |
|---|---|
| **Funksionet pyllit** | **Sipërfaqja ha** |
| Pyje prodhues ( për prodhim te lendes drunore | 1834.67 |
| Pyje mbrojtës (tokës, ujerave etj.) | 2993.84 |
| Pyje me funksion konservues(gjenetik) | 785.40 |
| **Gjithsej** | **5613.91** |

Sipërfaqja dhe volumi i pyjeve jepet në tabelën e mëposhtme :

| **Pyjet** | **Viti 1985** | **Viti 2021** | **Diferenca** |
|---|---|---|---|
| **Pyje gjithsej, ha** | 4552.70 | 5613.91 | +1061.21 |
| **Volumi i përgjithshëm, m³** | 540932 | 507790 | 6,336.9 |

**Prerja vjetore e lejuar/mundësia vjetore e shfrytëzimit**

Ne total, masat silvikulture janë:

Ndërhyrjet silvikulture me prerje përfshijnë:

Sipërfaqja totale ku do te ndërhyhet është 2678.2 ha. Nga ndërhyrjet do te vilet një material drusor prej 8789.3m³. Nga kjo;

Rrallime paratregtare, do ndërhyhet ne 1141.33 ha dhe do vilet 518.45 m³.

Rrallime tregtare, do ndërhyhet ne 1478.67 ha, me volum qe do vilet 7557.60 m³

Ricungime – do ndërhyhet ne 0.0 ha dhe do vilet 0.0 m³.

Rigjenerime me fare ahut do ndërhyrë ne sipërfaqen prej 6.2 ha ne tokat e zhveshura ne sipërfaqet me kullota artificiale, ne total do pyllëzohen 43.85 ha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALËSI E MADHE

Ne trungishte parashikohet ndërhyrje me prerje me te zgjedhur ne 2 parcela me sipërfaqe 52 ha me volum 4755m3 dhe konkretisht ne parcelat nr.34b dhe 113b me rrallime tregtare. Sipërfaqja ku do te ndërhyhet është 1478.67 ha dhe volumi i lendes qe do nxirret nga kjo ndërhyrje vlerësohet ne 7557 $m^3$.

Nga këto ne cungishte , ne këtë ekonomi parashikohet te ndërhyhet ne 879 ha dhe volumi i parashikuar qe mund te përfitohet është 1059 $m^3$.

Materiali qe do te rezultojë nga ndërhyrjet do te përdoret/shitet për dru zjarri kryesisht për komunitetin e zonës.

Ndërhyrje te tjera do te behën ne sipërfaqet e degraduara dhe ato te kullotave

Konkretisht,

1. Ne parcelën 66b është propozuar mbjellje fare ahut ne një sipërfaqe 6.2 ha

| | Totali ekonomisë | | Cungishte | | Trungishte | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Ndërhyrjet qe propozohen | Sipas, ha | Volumi, $m^3$ | Sip., ha | Volumi, $m^3$ | Sip., ha | Volumi, $m^3$ |
| Rrallime paratregtare (<6cm) | 1141.33 | 518.45 | 1127 | 500 | 14.33 | 18.45 |
| Rrallime tregtare (>6cm) | 1478.67 | 7557.60 | 879 | 1058.85 | 599.67 | 6498.75 |
| Ricungime | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Prerje me te zgjedhur | 52.0 | 713.25 | 0 | 0 | 52 | 713.25 |
| Rigjenrim me fare ahut | 6.2 | 0 | 0 | 0 | 6.2 | 0 |
| Totali | **2678.2** | **8789.3** | **2006** | **1558.85** | **672.2** | **7230.45** |

## Objektivat specifike mbi tipet e pyjeve

Për çuarjen e grumbujve drejt normalitetit (fondi real drejt fondit normal) janë propozuar masa konkrete në drejtimi të harmonizimit te tre komponentëve (Fond-Strukturë-Gjendje) të pyllit, përshtatur funksioneve përkatëse nëpërmjet:

- Rritjes ne prodhim sasisë të grumbujve pyjore (ndërhyrja me trajtime silvikulture e shfrytëzime ne grumbujt që kane arritur moshën e pjekurisë).
- Përdorimit optimal të stacionit.
- Sigurimit të gjeneratës së re në rrugë natyrore, me prerje rrah e përmirësime.
- Ruajtjes te biodiversitetit të florës e faunës.
- Mbrojtjes te pyjeve nga zjarret dhe prerjet pa leje.
- Rehabilitimit të infrastrukturës rrugore.
- Krijimit të tregut te punës.
- përmirësimit te gjendjes së përkujdesjes për pyjet.
- Rritja e investimeve dhe gjendjes se përkujdesjes.

REPUBLIKA E SHQIPERISË BASHKIA

## Objektivat specifik silvikulturore

Në përshtatje të mjedisit lokal dhe karakteristikave te grumbullit, do të zbatojmë sisteme silvikulture për realizimin e një përdorimi optimal të pyjeve.
Do te kryhen një sëre punimesh silvikulture duke filluar që nga pastrimet, rrallimet, prerjet e ndryshme silvikulturore si dhe pyllëzime artificiale. Me ane te tyre synohet përmirësimi i gjendjes aktuale duke gërshetuar të gjithë komponentët së bashku (teknike dhe sociale). Ndërhyrjet silvikulturale do të kryhen në përshtatje me objektivat e planit te mbarështrimit, kushtet e stacionit dhe cilësinë e grumbullit.

**Objektivat kryesore silvikulturore konsistojnë në:**

1. shfrytëzimin e pyjeve te pjekur e të tejpjekur.
2. rrallimin e grumbujve pyjorë.
3. sigurimin e ripërtëritjes.
4. shëndetësimin e grumbujve.
5. m bareshtrimin dhe ruajtjen e biodiversitetit

## Përfundime

Duke harmonizuar mendimin e komunitetit me atë teknik në project janë propozuar punime të ndryshme si rrallime para komerciale dhe komerciale, heqje barërash nga kullota duke zbatuar rigorozisht kriteret teknike te trajtimit silvikülturor qe krahas vjeljes së materialit drusor, te sigurohen kushte për instalimin e breznisë së re, si dhe vegjetacionit potencial natyror si garanci për zhvillim të qëndrueshëm te pyjeve te ekonomisë pyjore Bzhetë - Dedaj.

## 2. EKONOMIA PYJORE " BAJZË - HOT"

### Informacion i përgjithshëm rreth Ekonomisë pyjore

Ekonomia pyjore e Bajze-Hot shtrihet ne territorin e bashkisë Malësi e Madhe dhe aktualisht administrohet nga kjo bashki, dikur administrohej nga DSHP Malësia e Madhe. Sipërfaqja totale e ekonomisë pyjore Bajze-Hot është 3273.427ha. Plani i mbareshtrimit është i vlefshëm për periudhën kohore nga 2021 deri 2031.Plani i mbareshtrimit është i vlefshëm për periudhën kohore deri 2031. Plani i ri i mbareshtrimit hartohet sepse kemi një ndarje te re territoriale administrative dhe ndryshim kufijsh, gjithashtu plani i vjetër i mbarështrimit të pyjeve e ka humbur vlefshmërie që prej shumë vitesh. Ekonomia pyjore është me te njëjtin emër dhe ka patur një sipërfaqe totale prej 5153.1 ha, ndërsa me planin e ri dhe ndarjen e re territoriale kjo sipërfaqe arrijnë ne 3273.427 ha. Një tjetër arsye është se bashkia Malësia e Madhe ka siguruar mbështetje financiare për hartimin e planeve të menaxhimit te pyjeve dhe kullotave në territorin e saj. Përshkrimi i përgjithshëm i ekonomisë ka për qëllim njohjen dhe evidentimin e problemeve teknike dhe sociale të mprehta të zonës ku do te kryhet mbarështrimi, në mënyre që të gjejnë pasqyrim në objektivat e mbareshtrimit për të ardhmen. Mbarështrimi i grumbujve pyjore të ekonomisë pyjore "Bajzë - Hot" ka synuar dhe synon që nëpërmjet zbatimit të një silvikulture natyralistike të garantojë strukturën shumëmoshare, te ruajë biodiversitetin ne përputhje me karakteristikat ekologjike stacionare, te sigurojë vijueshmërie e prodhimeve te pyllit dhe veçanërisht ripërtëritjen natyrore dhe shumë funksione të grumbujve pyjore.

### Vendodhja gjeografike dhe ndarja administrative

Ekonomia pyjore Bajze-Hot shtrihet ne vargmalet veriore e verilindore te Malësisë se Madhe, qe gjarpërojnë ne dy krahët e fushës Bajze-Hot. Këto vargmale formojnë një bazën te madh ujëmbledhës ku te gjitha ujerat derdhen ne zonën e fushës se Bajzës.

Emërtimi saj ka ardhur pikërisht nga emri i fshatit. Ekonomia ka kufij natyrore te qarte si me poshtë:

1. **Ne veri** - Komunën Kelmemd,pjeserisht nga Ek.Py. Fushe Zeze
2. **Ne lindje** – me Komunen Qender (Koplik), Ek.Py. Koplik-Gruemine.
3. **Ne jugu** – me komunen Shkrel, nga Ek.Py. Fusha e Zeze dhe Kastrat-Zagore
4. **Ne perendim** –me kufirin me Malin e Zi dhe ujrat e liqenit te Shkodres

### Rezultatet kryesore

Mbarështimi i ekonomisë pyjore "Bajzë - Hot" ka vlefshmeri përdorimi për nje periudhë 10 vjeçare (2021-2031).

Ekonomia pyjore ka një sipërfaqe te përgjithshme prej **10336.168** ha dhe sipas përdorimit te territorit ka ketë strukture :

- sip. pyll 2767.08 ha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALËSI E MADHE

| | |
|---|---|
| - sip. jo pyjore | 7628.27 ha |
| - sip. bujqesore | 3943.16 ha |
| - kullote | 1772.857 ha |
| - urbane | 455.6 ha |
| - ujore | 24.64 ha |
| -pemetore | 1776.97ha |
| - djerre | 27.88 ha |
| - siperfaqe shkembore | 3.9 ha |
| -zone industrial | 9.51 ha |

Sipas planit te ri të mbaréshtrimit dhe ndarja e grumbujve pyjorë sipas formés se qeverisjes éshtë si vijon:

| Forma e qeverisjes | Aktual | | I propozuar | |
|---|---|---|---|---|
| | **Ha** | **%** | **Ha** | **%** |
| Trungishte | 136.441 | 4.2 | 425.691 | 13 |
| Cungishte | 926.606 | 28.3 | 1205.516 | 36.9 |
| Cungishte e perbere | 71.328 | 2.2 | 71.328 | 2.2 |
| Shkurre | 1632.705 | 49.9 | 1064.545 | 32.5 |
| Kullota/livadhe | 480.817 | 14.6 | 480.817 | 14.6 |
| Sip. jo pyjore | 25.53 | 0.8 | 25.53 | 0.8 |
| **Total** | **3273.427** | **100** | **3273.427** | **100** |

Mbeshtetur ne mbareshtrimin e vitit 1985 rezulton te kemi një sipërfaqe pyjore prej 2653.8 ha nga e cila pyje prodhues 1758.4 ha, pyje mbrojtës 894.4ha. Ndërsa persa i përket formës se qeverisje pyjet trungishte janë 392.6 ha, cungishte 471 ha dhe shkurre 1790.2 ha.

Tipet e pyjeve përbejnë masivet pyjore të ekonomisë jan:

Per fondin pyjor te ekonomise pyjore Bajze-Hot shperndarja e siperfaqes se pyjeve sipas tipit te pyjeve eshte si me poshte:

| **Tipi i pyjeve** | **Sip(ha)** | **% ndaj siperfaqes pyjore** | **% ndaj siperfaqes totale te f.pyjor** |
|---|---|---|---|
| Pyje dominuar nga pishe e zeze | 7.811 | 0.7 | 0.2 |
| Pyje dominuar nga pisha boshnjake | 7.37 | 0.6 | 0.2 |
| Pyje dominuar nga frasheri i zi | 7.704 | 0.7 | 0.2 |
| Pyje dominuar nga qarri | 93.552 | 8.2 | 2.9 |
| Pyje dominuar nga ahu | 392.506 | 34.6 | 12.0 |
| Pyje dominuar nga shkoza e zeze | 187.77 | 16.6 | 5.7 |
| Pyje dominuar nga shkoza e bardhe | 322.23 | 28.4 | 9.8 |
| Pyje dominuar nga frasher fletengushte | 21.008 | 1.9 | 0.6 |
| Pyje dominuar nga krifsha fletengushte | 27.937 | 2.5 | 0.9 |
| Pyje dominuar nga dellinje e zeze | 66.487 | 5.9 | 2.0 |
| **Totali** | **1134.375** | **100** | **34.7** |

Sipërfaqen më të madhe e zënë pyjet e dominuar nga lloji ah.

Sipërfaqja dhe volumi i pyjeve jepet si me poshte;

Shperndarja e sipërfaqes dhe volumit sipas formës se qeverisjes për ekonominë e marre ne studim sipas formës se qeverisjes është e ndare si me poshtë:

1. Pyje gjithsej janë .............3273.427 ha dhe volum....................41504 m³ nga te cilët;
2. Trungishte............................136.441 ha, me volum........................9900 m³

1. Cungishte..............................926.606 ha, me volum .....................28914m³
2. Shkurre.................................1632.705 ha, me volum...............................m³

3. (Cungishte + Trungishte)......71.328 ha, me volum......................2690 $m^3$
4. kullota ..............................480.817 ha, me volum............................ $m^3$
5. Sip. jo pyjore......................25.53 ha, me volum..........................$m^3$

## Prerja vjetore e lejuar/mundësia vjetore e shfrytëzimit

Nga analiza e grumbujve pyjor te ekonomisë rezulton se ata janë kryesisht ne fazën e zhvillimit te rinise, para pjekurisë dhe pjekurisë, vetëm një ngastër është mbi 50 vjeçare. Vërtet grumbujt pyjor janë ne këto faza zhvillimi por dimensionet e tyre dendrometrike janë te vogela, po ashtu për një periudhe te gjate kohore nuk janë kryer punime silvikulture. Nisur nga arsyet e sipërpërmendura ne ketë ekonomi pyjore ***nuk janë planifikuar ndërhyrje shfrytëzimi te lendes drusore.*** Te gjitha produktet pyjore qe do te vilen ne periudhën 10-vjeçare janë ato qe do te rezultojnë prej trajtimit silvikultura te pyjeve (rrallime para tregtare, rrallime tregtare dhe ricungime). Pra, sasia e materialit drusor qe do te nxirret nga ndërhyrjet silvikulture, ne zbatim te këtij plani menaxhimi do te jete rreth 861.7$m^3$ne vit.

## Objektivat specifike mbi tipet e pyjeve

Për çuarjen e grutnbujve drejt normalitetit (f0ndi real drejt fondit normal)janë propozuar Inasa konkrete në drejtim të harmonizimit të tre komponentëve (Fond-Strukturë-Gjëndje) të pyllit, përshtatur funksioneve përkatëse nëpërmjet:

1. Rri(jes së prodhimtarisë të grumbujve pyjore (ndërhyrja me trajtime e shfrytëzime në grumbujt që kanë arritur moshën.)

- Përdorimit optimal të stacionit.
- Sigurimit të gjeneratës së re në rrugë natyrore, me prerje të njëpasnjëshme, prerje rrah dhe përmirësime.
- Ruqigjes së biodiversitetit, të florës e faunës.
- Mbrojtjes së pyjeve nga zjarret dhe prerjet pa lejë.
- Rehabilitimit të infrastrukturës rrugore.
- Krijimit të tregut të punës.
- Përmirësimit të gjendjes së përkujdesjes për pyjet.

## Objektivat specifik silvikulture

Në përshtatje të nuiedisit lokal dhe karakteristikave të grumbullit, do të zbatojmë sisteme silvikulturale për realizimin e një përdorimi optimale të pyjeve.

Do të kryhen një sëre punimesh silvikulturore duke filluar që nga pastrimet, rrallimet, prerjet e ndryshme silvikulture si dhe pyllëzime aflificiale. Më anë të tyre synohet përmirësimi i gjendjes aktuale duke gërshetuar të gjithë komponentët së bashku (teknike dhe sociale).

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA MALESI E MADHE

Ndërhyrjet silvikulturale do të kryhen në përshtatje me objektivat e planit të mbarështrimit, kushtet e stacionit dhe cilësinë e grumbullit.

Objektivat kryesore silvikulture konsistojnë në:

1. shfrytëzimin e pyjeve të pjekur e të tejpjekura.
2. rrallimin e grumbujve pyjore.
3. sigurimin e ripërtëritjes.
4. shëndetësimin e grumbujve.
5. mbarështrimin dhe ruajtjen e biodiversitetit

**Përfundime**

Në aspektin e organizimit natyror kjo ekonomi paraqet një ndërthurje të mirë të elementeve ekstensiv dhe intensive të menaxhimit të burimeve pyjore, kullotave, fondit bujqësor, ujera, florës, faunës dhe mbi të gjitha faktorit njeri si përfitues, përdorues i këtyre burimeve. Pavarësisht kësaj, kërkohet një edukim i vazhdueshëm për menaxhimin e qëndrueshëm dhe vënien në funksion të përmirësimit të cilësisë së jetesës për komunitetin të këtyre burimeve.

## 3. EKONOMIA PYJORE " KASTRAT - ZAGORË"

### Informacion i përgjithshëm rreth Ekonomisë Pyjore

Ekonomia pyjore e "Kastrat-Zagore" shtrihet ne territorin e bashkisë "Malësi e Madhe" dhe aktualisht administrohet nga kjo bashki, dikur administrohej nga DSHP Malësie Madhe. Sipërfaqja totale e ekonomisë pyjore Kastrat-Zagore është 5351.11ha. Plani i mbareshtrimit është i vlefshëm për periudhën kohore nga 2021 deri 2031. Plani i ri i mbareshtrimit hartohet sepse kemi një ndarje te re territoriale administrative dhe ndryshim kufijsh, gjithashtu plani i vjetër i mbareshtrimit te pyjeve e ka humbur vlefshmërinë qe prej shume vitesh, por edhe plani i mbareshtrimit te pyjeve komunal te Njësisë administrative Kastrat e ka humbur qe prej kater vitesh vlefshmërinë e tij. Një tjetër arsye është se bashkia Malësi e Madhe ka siguruar mbështetje financiare për hartimin e planeve te menaxhimit te pyjeve dhe kullotave ne territorin e saj. Ekonomia pyjore është me te njëjtin emër dhe ka patur një sipërfaqe totale prej 5534 ha, ndërsa me planin e ri dhe ndarjen e re territoriale kjo sipërfaqe arrijnë ne 5351.11 ha. Përshkrimi i përgjithshëm i ekonomisë ka për qellim njohjen dhe evidentimin e problemeve teknike dhe sociale te mprehta te zonës ku do te kryhet mbareshtrimi, ne mënyre qe te gjejnë pasqyrim ne objektivat e mbareshtrimit për te ardhmen.

Mbareshtrimi i grumbujve pyjore te ekonomisë pyjore "Kastrat-Zagore" ka synuar dhe synon qe nëpërmjet zbatimit te një silvikulture natyralistike te garantoje strukturën shumemoshare, te ruaje biodiversitetin ne përputhje me karakteristikat ekologjike stacionare, te siguroje vijueshmërinë e prodhimeve te pyllit dhe veçanërisht ripërtëritjen natyrore dhe shume funksione te grumbujve pyjore.

### Vendodhja gjeografike dhe ndarja administrative

Ekonomia pyjore Kastrat-Zagore shtrihet ne fshatin Zagore, Kastrat,Vrith, nga Veleçiku deri ne prroin e thate, ne inventarizimin e meparshem kjo ekonomi është emërtuar ekonomia pyjore Kastrat -Zagore ,Vrith dhe ne te riun eshte lene ky emertim. Ekonomia ka kufij natyrore te qarte si me poshte:

- **Ne veri** - kufizon me Qafa Bardhaj,Lugu.
- **Ne lindje** - me fshatin Veleçik Razem
- **Ne jugu** - me fshatrat e Perroi i thate.
- **Ne perendim** - me Mali i Gradecit, Qafe grisha.

### Rezultatet kryesore

Mbarështimi i ekonomisë pyjore "Kastrat-Zagorë" ka vlefshmeri përdorimi për një periudhë IO vjeçare (2021-2031).

Përdorimi i territorit giatë realizimit të planit të mbarshtrimit të sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullosor paraqitet si më poshtë vijon:

| Perdorimi | 1985 | | 2021 | |
|---|---|---|---|---|
| | *Ha* | *%* | *Ha* | *%* |
| Pyje | 512.2 | 9.2 | 2880.95 | 53.8 |
| Kullota, livadhe | 226 | 4.1 | 534.98 | 10 |
| Shkurre | 3389.4 | 61.3 | 1896.84 | 35.5 |
| Toke bujqesore + Urbane | 764 | 13.8 | 19.98 | 0.4 |
| Siperfaqe jo pyjore | 0 | 0 | 16.44 | 0.3 |
| Djerr ( eroduar) | 125.3 | 2.3 | 0 | 0 |
| Te tjera | | | 1.92 | 0.001 |
| - *Inproduktive , shkembore* | 518 | 9.3 | 0.86 | 0 |
| - *Sip. e hapur* | 0 | 0 | 1.06 | 0 |
| **Total** | **5534** | **100** | **5351.11** | **100** |

Sipas planit të ri të mbarështrimit ndaria e grumbujve pyjorë si mbas formës së qeverisjes është si vijon:

| Forma e qeverisjes | Aktual | | I propozuar | |
|---|---|---|---|---|
| | Ha | % | Ha | % |
| Trungishte | 428.41 | 8 | 428.41 | 8 |
| Cungishte | 2253.30 | 42.1 | 2253.30 | 42.1 |
| Trungishte e perbere | 6.48 | 0.1 | 6.48 | 0.1 |
| Cungishte e perbere | 192.76 | 3.6 | 192.76 | 3.6 |
| Shkurre | 1896.84 | 35.5 | 1896.84 | 35.5 |
| Kullote | 534.98 | 10 | 534.98 | 10 |
| Toke bujqesore + troje | 19.98 | 0.4 | 19.98 | 0.4 |
| Siperfaqe jo pyjore | 16.44 | 0.3 | 16.44 | 0.3 |
| Te tjera | 1.92 | 0.1 | 1.92 | 0.1 |
| - *Inproduktive, shkembore* | 0.86 | | 0.86 | |
| - *Siperfaqe boshe)* | 1.06 | | 1.06 | |
| **Total** | **5351.11** | **100** | **5351.11** | **100** |

Tipet e pyjeve përbejnë masivet pyjore të ekonomisë janë:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALËSI E MADHE

Brenda ekonomisë pyjore tipet e grumbullit aktual sipas funksioneve dhe përqindja ndaj totalit të sipërfaqes pyjore jepen .

| Tipi i grumbullit | Sip.Ha | % ndaj totalit | % ndaj sip.pyjore |
|---|---|---|---|
| Pyje me pishe e zeze | 72.42 | 1.4 | 1.5 |
| Pyje me rrobull | 35.58 | 0.7 | 0.8 |
| Pyje me ah | 617.68 | 11.5 | 12.9 |
| Pyje me qarri | 179.83 | 3.3 | 3.8 |
| Pyje me lajthi te eger | 40.27 | 0.7 | 0.8 |
| Pyje me shkoze te bardhe | 1791.95 | 33.5 | 37.5 |
| Pyje me shkoze te zeze | 1171.30 | 21.9 | 24.5 |
| Pyje me frasher | 287.44 | 5.4 | 6.0 |
| Pyje me melleze | 32.32 | 0.6 | 0.7 |
| Pyje me shkurre miks | 549.00 | 10.3 | 11.5 |
| GJITHESEJ | **4777.79** | **89.3** | **100** |

Sipërfaqen totale e zënë pyjet e dominuar nga lloji Shkozë e Bardhë.

Sipërfaqja dhe volumi i pyjeve jepet në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm:
Shperndarja e siperfaqes dhe volumit sipas formes se qeverisjes per ekonomine e marre ne studim sipas formes se qeverisjes eshte e ndare si me poshte:

- Pyje gjithsej jane ...............5351.11 ha dhe volum....................113310 m³ nga te cilet;
- Trungishte...........................428.41 ha, me volum....................30215 m³,
- Cungishte..........................2253.30 ha, me volum .................75484 m³,
- Shkurre..............................1896.84 ha, me volum..............................m³,
- ( Trungishte + Cungishte).......6.48 ha, me volum.........................286 m³
- (Cungishte + Trungishte)......192.76 ha, me volum....................7325 m³

Volumi i përgithshëm i masës drunore është rreth 113310 m³.

**Prerja vjetore e lejuar/mundësia vjetore e shfrytëzim**

Nga analiza e grumbujve pyjor te ekonomise rezulton se ata jane ne kryesisht ne fazën e zhvillimit te rinise, para pjekurisë dhe pjekurisë. Vërtet grumbujt pyjor janë ne këto faza zhvillimi por dimensionet e tyre dendrometrike janë te vogëla, po ashtu për një periudhe te gjate kohore nuk janë kryer punime silvikulture. Nisur nga arsyet e sipërpërmendura ne ketë ekonomi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALËSI E MADHE

pyjore ***nuk janë planifikuar ndërhyrje shfrytëzimi te lendes drusore***. Te gjitha produktet pyjore qe do te vilen ne periudhën 10-vjeçare janë ato qe do te rezultojnë prej trajtimit silvikultura te pyjeve (rrallime para tregtare dhe, rrallime tregtare dhe ripunime).

Sasia e materialit drusor qe do te nxirret nga ndërhyrjet silvikulture, ne zbatim te këtij plani menaxhimi do te jete rreth 2559.3m³ne vit.

### Objektivat specifike mbi tapet e pyjeve

Për çuarjen e grumbujve drejt normalitetit (fondi real drejt fondit normal) janë propozuar masa konkrete në drejtim të harmonizimit të tre komponentëve (Fond-Strukturë-Gjendje) të pyllit, përshtatur funksioneve përkatëse nëpërmjet:

1. Ritës së prodhimtarisë të grumbujve pyjore (ndërhyrja me trajtime e shfrytëzime në grumbujt që kanë arritur moshën e pjekurisë.
2. Përdorimit optimal të stacionit.
3. Sigurimit të gjeneratës së re në rrugë natyrore, me prerje rrah e përmirësime.
4. Ruajtjes të biodiversitetit të florës e faunës.
   - Mbrojtjes të pyjeve nga (jarret dhe prerjet pa leje.
   - Rehabilitimit të infrastrukturës rrugorë.
   - Krijo imët të tregut të punës.
   - Përmirësimit të gjendjes së përkujdesjes për pyjet.

### Objektivat specifik silvikulturale

Në përshtatje të mjedisit lokal dhe karakteristikave të grumbullit, do të zbatojmë sisteme silvikulturale për realizilllin e një përdorimi optimal të pyjeve.

Do të kryhen një sërë punimesh silvikulturore duke filluar që nga pastrimet, rrallimet, prerjet e ndryshme silvikulturore si dhe pyllëzime artificiale. Me anë të tyre synohet përmirësimi i gjendjes aktuale duke gërshetuar të gjithë komponentët së bashku (teknike dhe sociale).

NdërhY1jet silvikulturale do të kryhen në përshtatje Me objektivat e planit të mbarështrilnit, kushtet e stacionit dhe cilësinë e grumbullit.

Objektivat kryesore silvikulturore konsistojnë në :

- shfrytëzimin e pyjeve të pjekur e të tejpjekur.
- rrallilïlin e grumbujve pyjorë.
- sigurimin e ripërtëritjes.
- shëndetësimin e grumbujve.
- mbarështrimin dhe ruajtjen e biodiversitetit

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ASHKIA MALESI E MADHE

**Përfundime**

Duke harmonizuar mendimin e komunitetit me ate teknik në project janë propozuar punime të ndryshme si rrallime para komerciale dhe komerciale, heqje barërash nga kullota duke zbatuar rigorozisht kriteret teknike te trajtimit silvikülturor qe krahas vjeljes së materialit drusor, te sigurohen kushte për instalimin e breznisë së re, si dhe vegjetacionit potencial natyror si garanci për zhvillim të qëndrueshëm te pyjeve te ekonomisë pyjore Kastrat-Zagorë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALËSI E MADHE

## 4. EKONOMIA PYJORE " KOPLIK - GRUEMIRË "

### Informacion i përgjithshëm rreth Ekonomisë Pyjore

Ekonomia pyjore e Koplik-Gruemirë shtrihet ne territorin e bashkisë Malësi e madhe" dhe aktualisht administrohet nga kjo bashki, dikur administrohej nga DSHP Shkodër. Sipërfaqja totale e ekonomisë pyjore Koplik-Gruemirë është **5595.45** ha. Plani i mbareshtrimit është i vlefshëm për periudhën kohore nga 2021 deri 2031. Plani i ri i mbareshtrimit hartohet sepse kemi një ndarje te re territoriale administrative dhe ndryshim kufijsh, gjithashtu plani i vjetër i mbareshtrimit është ne vitin e fundit te vlefshmërisë se tij. Një tjetër arsye është se bashkia Malësi e Madhe" ka siguruar mbeshtetje financiare për hartimin e planeve te menaxhimit te pyjeve dhe kullotave ne territorin e saj. Ekonomia pyjore është me te njëjtin emër dhe ka patur një sipërfaqe totale prej **6531.76** ha, ndërsa me planin e ri dhe ndarjen e re territoriale kjo sipërfaqe arrijnë ne **5595.45** ha. Përshkrimi i përgjithshëm i ekonomisë ka për qellim njohjen dhe evidentimin e problemeve teknike dhe sociale te mprehta te zonës ku do te kryhet mbarështimi, ne mënyre qe te gjejnë pasqyrim ne objektivat e mbareshtrimit për te ardhmen.

Mbareshtrimi i grumbujve pyjore te ekonomisë pyjore" Koplik-Gruemirë" ka synuar dhe synon qe nepermjet zbatimit te nje silvikulture natyralistike te garantoje stukturen shumemoshare, te ruaje biodiversitetin ne perputhje me karakteristikat ekologjike stacionale, te siguroje vijueshmërinë e prodhimeve te pyllit dhe veçanërisht ripërtëritjen natyrore dhe shume funksione te grumbujve pyjore.

### Vendodhja gjeografike dhe ndarja administrative

Ekonomia pyjore Koplik-Gruemirë"shtrihet ne pjesën e bazeniit te perroit te thatë ,ne vendin e quajtuar Koplik i poshtëm ,Koplik i sipërm ,lohe dhe vazhdon ne drejtim te jug-lindjes me fshatin rec,qaf gjode,luke,gruemire dhe perfundon tek ura e riollit fshatit. Ekonomia ka kufij natyrore te qarte si me poshte:

- **Ne veri** - ME Bzhetë –dedaj,koplik,perroi i thate
- **Ne lindje** - Lugina e Rrjollit,Shkoder
- **Ne jugu** – Grizha,Koop-Grizhe, perroi i rishlit
- **Ne perendim** – Bajze-Hot,Shkoder-Koplik,Liqeni i Shkodres.

### Rezultatet kryesore

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALËSI E MADHE

Mbarështimi i ekonomisë pyjore "Koplik-Gruemirë" ka vlefshmeri përdorimi për një periudhë 10 vjeçare (2021-2031).

Përdorimi i territorit gjatë realizimit të planit të mbarshtrimit të sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullosor paraqitet si më poshtë vijon:

| Perdorimi | Aktuale | | E propozuar | |
|---|---|---|---|---|
| | *Ha* | *%* | *Ha* | *%* |
| Pyje | 2320.064 | 41.5 | 2320.064 | 41.5 |
| Shkurre | 1942.30 | 34.7 | 1942.30 | 34.7 |
| Kullota, liv adhe | 1130.26 | 20.2 | 1130.26 | 20.2 |
| Toke bujqesore | 127.5 | 2.3 | 127.5 | 2.3 |
| Urbane | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Siperfaqe jo pyjore | 7.1 | 0.13 | 7.1 | 0.13 |
| Djerr ( eroduar) | 0 | 0 | 0 | 0 |
| INPRODUKTIVE | 68.4 | 1.22 | 68.4 | 1.22 |
